

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Analiza e të dhënave në ekonomiks
Niveli:	BSc
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	3
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi:	Prof. Dr. Adriatik Hoxha
Detajet kontaktuese:	email: adriatik.hoxha@uni-pr.edu cell: +383 44 208 000
Përshkrimi i lëndës:	Pjesa e parë e kësaj lënde do të paralelizohet me lëndët e nivelit para-diplomik në statistikë të aplikuar, mirëpo me një thellësi plotësuese që të mbulojë çështjet praktike të cilat shpeshherë hasen nga analistët, p.sh. si të importohen datasetet, bërjen e grafikoneve për publikime, puna me peshat e anketave, modelimi i regresioneve. Pjesa e dytë e lëndës fokusohet në territorin e lëndëve të avancuara ose kërkimeve origjinale. Këtu studentët do të gjejnë informatat të ndryshme për ilustrimet grafike, regresionin e qëndrueshëm, kuantilet, regresionin jolinear, logjistik, logjistik të rradhitur, logjistik multinominal, ose regresionin Poisson. Më tutje studentët do të aplikojnë metoda të reja për modelimin e ekuacioneve strukturore ose imputimin e vlerave që mungojnë. Të dizajnojnë modelet survival-time dhe event-count. Të ndërtojnë dhe të prdorin variablat kompozite prej analizaës së faktorëve ose komponentit kryesor. Të ndajnë observimet në lloje ose klustere (grumbuj) empirike. Të analizojnë modelet e thjeshta dhe të shumëfishta të serive kohore. Të ndërtojnë modele me efekte me disa nivele (multilevel) ose me efekte të përziera (mixed-effects). Pjesa e tretë konkludon duke i shikuar aspektet e programimit në Stata. Studentët do të kryejnë analiza plotësuese më të avancuara në Stata, eksplorojnë programimin në Stata, qoftë për detyra të menaxhimit të specializuar të të dhënave, të ndërtimit të aftësive dhe/ose mundësive të reja statistikore, për eksperimente Monte Carlo, ose për mësimdhënie.
Qëllimet e lëndës:	Lënda ka qëllim që të: • zhvillojë aftësitë analitike të studentëve që të kryejnë statistika/ekonometri të aplikuar duke e përdorur paketën statistikore. • zhvillojë aftësitë analitike të studentëve për të bërë modele statistikore për të testuar teoritë Ekonomike duke përdor Stata. • zhvillojë kapacitetet programuese të studentëve në Stata.
	Në fund të lëndës, studentët duhet të jenë në gjendje që të:

Rezultatet e pritura të të mësuarit:	• kryejnë në mënyrë të pavarur analiza statistikore/ekonometrike duke e përdorur Stata, në kombinim me aplikacionit e tjera siç është Microsoft Excel. • kryejnë analiza të thella dhe kritike të teorive Ekonomike duke e përdor modelimin e avancuar ekonometrik. • zhvillojnë programimin e avancuar në Stata.		
Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime	1	15	15
Punë praktike	1	15	15
Kontaktet me mësime të theksuara/ konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokviume			
Koha e studimit vetanake të studentit	1	10	10
Përgaditja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	10	1	10
Total			100
Metodologjia e mësimit:	Kjo lëndë do të ofrohet përmes kombinimit të materialit të lëndës, librave, softuerëve statistikorë, sllajdeve të ligjeratave, detyrave gjatë ligjeratës dhe gjetjes së zgjidhjeve.		
Metoda e vlerësimit:	• Pjesëmarrja 10% e notës finale. • Aktiviteti në ligjeratë 15% e notës finale. • Projekti empirik, 25% e notës finale. • Provimi final, 50% e notës finale.		
Literatura:			
Literatura bazë:	Hamilton, L. C. 2012. Statistics with Stata 12. Updated for Version 12. Cengage Learning. SBN-13: 978-0-8400-6463-9, ISBN-10: 0-8400-6463-2.		
Literatura plotësuese:	STATA. 2021. STATA User's Guide Release 17. ISBN-10: 1-59718-353-9 ISBN-13: 978-1-59718-353-6.		
Plani i dizajnuar i mësimit:			
Java	Ligjërata që do të zhvillohet		
Java e I-rë:	1. Stata dhe Resurset e Stata		
Java e II-të:	2. Menaxhimi i Të Dhënave		
Java e III-të:	3. Grafikonet		
Java e IV-të:	4. Të Dhënat e Survejeve (Anketave)		
Java e V-të:	5. Statistikat Përmbledhëse dhe Tabelat		
Java e VI-të:	6. ANOVA dhe Metodën e Tjera Krahësuese		
Java e VII-të:	7. analiza e Regresionit Linear		
Java e VIII-të:	8. Metodën e Avancuar të Regresionit		
Java e IX-të:	9. Regresioni Logjistik		
Java e X-të:	10. Modelet e Mbijetesës dhe Llogaritjes së Ngjarjeve		
Java e XI-të:	11. Analiza e Komponentit Primar, Faktorëve dhe Klusterit		
Java e XII-të:	12. Analiza e Serive Kohore		
Java e XIII-të:	13. Modelimi në Disa Nivele edhe me Efekte të Përziera (Multilevel dhe Mixed-Effects Modeling)		
Java e XIV-të:	14. Prezentimi i Programimit		

Java e XV-të:	15. Projekti Empirik
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimi duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fiken (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimi. Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara. Kopjimi dhe transmetimi i fjalëve nuk lejohet në këtë lëndë. Nëse studentët takohen në këto aktivitete, ata do të trajtohen në bazë të rregulloreve përkatëse të Universitetit të Prishtinës. Me këtë rast do të merr notën e dobët dhe ky aktivitet do të përcillet në shënimet personale të tyre.	